

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari, Kujtim Krasniqi, me Zyrtaren Ligjore Dafina Ymeri, në çështjen penale kundër të pandehurit J. G. nga Fsh.B. M. – F. K., për shkak të veprës penale Rrezikimi i trafikut publik, nga neni 3778, par. 6, lidhur me par. 1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.2910/14, të datës 10.10.2014, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, në prezencën e prokurores së shtetit Fatmire Cacaj, të akuzuarit, e me datën. 09.06.2017, mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari;

J. G., nga i ati S., e ëma R., e gjinisë P. i lindur me datë *data e lindjes...* nga Fsh. B. M. Komuna F. K., ku edhe jeton, me nr. personal *numri personal...*, ka të kryer shkollën e mesme, i punësuar, i martuar, baba i dy fëmijëve, gjendja e mesme Ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse me datën 14.02.2014. rreth orës 16:45min, në Prishtinë në rrugën “Nena Terezë” i pandehuri nga pakujdesia e ka shkaktuar aksidentin e komunikacionit me ç ‘rast janë shkaktuar dëme materiale dhe lëndime trupore, ndaj viktimës L. H. G. , me këtë i njëjti ka ra ndesh me nenin 54.1 dhe 150 të LSKRR-se në momentin kur në kohën e vendit dhe ditën si me lart e ka drejtuar automjetin e tipit VW, viti i prodhimit 1991, me targa *numri i targave...*, me ngjyre të gjelbër, ku në pjesën e përparme e godet këmbësoren, Me qe një veprim i tillë ka qene i ndaluar me dispozita të komunikacionit, ku sipas ekspertizës së ekspertit të datës 15.07.2014 del se i pandehuri nuk ia ka përshtatur shpejtësinë kushteve dhe rrethanave në rrugë, duke ndërmarr një veprim akoma pa u bindur me parë se një veprim të tillë do të përfundonte pa e penguar askënd në trafikun publik rrugor si në rastin konkret duke mos pas kujdes ndaj pjesëmarrësve tjerë të komunikacionit e këtë rast të dëmtuarës këmbësore në vendkalim për këmbësor nga se si pasoj e veprës penale të lartcekur e dëmtuara L. G., ka pësuar Lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin.

-me këtë ka kryer veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata konform nenit 4, 7, 17,49, 51,52, 73 të KPRK-së si dhe nenit 365 dhe 326 të KPPRK-së, të njëjtit i shqipton

DËNIMIN ME KUSHT

Ashtu që të akuzuarin **J. G.** e gjykon me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 2 (dy) muajve, ndërsa gjykata dënimin e shqiptuar nuk do ta ekzekuton në afatin kohor prej 1 (një) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale.

Obligohet; i akuzuari që të në emër të shpenzimeve të procedurës penale gjykatës t’ia kompensojnë shumën prej **40.88 euro** për ekspertizën e komunikacionit, **20 euro** për ekspertizë mjeko-ligjore si dhe në emër të paushallit gjyqësor gjykatës t’ia kompensojnë shumën prej **30 euro**, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën ekzekutimi i dënimit do të bëhet me detyrim .

E dëmtuara: L. (H.) Go. nga Fsh. G. Komuna F. K., udhëzohet që kërkesën pasurore juridike ta realizojnë në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë ka paraqitur aktakuzën PP.II.nr.2910/14, të datës 10.10.2014 kundër të akuzuarit J. G. nga Fsh B. M. – F. K., për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe ka mbajtur shqyrtimin gjyqësor me dt;07.06.2017, dhe pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit, të pandehurit iu dha mundësia për ta pranuar fajësinë apo të deklarohet i pafajshëm.

I pandehuri në shqyrtimin gjyqësor, me vullnet të plotë dhe i vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë, e ka pranuar në tërësi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë sipas aktakuzës së prokurorisë së shtetit, PP.nr.2910/14, të datës 10.10.2014.

Pas deklarimit të pandehurit se ndjehet fajtor për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet nga Prokuroria, gjykata me Aktvendim pranoi pranimin e fajësisë nga i pandehuri pasi që është bindur plotësisht se ishte i vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë.

Prokurori i Shtetit dha mendimin e tij lidhur me deklarimin e fajësisë së të pandehurit, dhe shtoi: I akuzuari me deklarimin e pranimit të fajësisë me veprën penale që i ngarkohet, të njëjtin deklarim e ka bere në përputhje me dispozitën e nenin 248 të KPPRK-se andaj Prokuroria Themelore në Prishtine pajtohet me pranimin e fajësisë të deklaruar nga ana e tij.

I pandehuri deklaroi se për këtë vepër penale ndihet fajtor dhe përgjegjës, shpreh keqardhje për atë që ka ndodhur, është hera e pare që me ka ndodhur një gjë të tillë, për fat të mire nuk është lënduar shume vajza, unë jam kujdesur për të pas aksidentit, i premtoj gjykatës se do të jem edhe me i kujdesshëm në komunikacion dhe i propozoj gjykatës që me rastin e matjes se dënimit të me caktoj një dënim sa më të lehtë.

Nga thëniet e vet të pandehurit në shqyrtimin gjyqësor u vërtetua se ai me datë kohë dhe vend si në dispozitivin e aktakuzës së ngritur ndaj tij ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Po ashtu nga shkresat e lëndës dhe nga provat materiale siç janë ekspertiza e komunikacionit dhe ekspertiza mjeko-ligjore si dhe foto dokumentacioni i cili gjendet në shkresat e lëndës, gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit formësohen të gjitha elementet qenësore objektive dhe subjektive të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, për të cilën akuzohet i pandehuri. Andaj, gjykata të njëjtin e shpalli fajtor, pasi që gjeti se penalisht është i përgjegjshëm dhe e gjykoj si në diapozitivin e këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit, gjykata i vlerësoi të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, të cilat konform nenit 73 të KPRK-së, ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit e të cilat janë me ndikim me rastin e dënimit, ashtu që si rrethana lehtësuese gjeti se: i pandehuri e pranoi fajësinë për veprën penale, se ishte korrekt dhe me sjellje korrekte në gjykatë, është hera e parë që ka rënë ndesh me ligjin, ka raporte të mira me të dëmtuarit, është familjar, vepra penale ka ndodhur nga pakujdesia dhe se i ka premtuar gjykatës së më nuk do të përsërisë vepra penale, dhe se do të jetë më i kujdesshëm në komunikacion, ndërsa rrethana veçanërisht rënduese gjykata gjeti rrezikshmërinë e veprës penale si dhe pasojën e shkaktuar pasi që në këtë aksident janë shkaktuar lëndime të rënda trupore, dhe duke u nisur nga të gjitha këto gjykata i shqiptoi dënimin si në diapozitivin e këtij aktgjykimi me bindje se ky dënim është adekuat me shkallën e rrezikshmërisë

shoqërore dhe shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit, i paraparë me nenin 50 të KPRK-së.

Në rastin konkret gjykata vlerësoi se dënimi i shqiptuar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi është në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljen dhe rrethanat e kryesit sipas nenit 73.par.2, me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e kryesit, me bindje se dënimi i tillë do të ndikoj në risocializimin dhe riedukimin e kryesve, si dhe do të ndikoj te të tjerët të mos kryejnë vepra penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i dënimit sipas nenit 41 të KPRK-së.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 450 par.2 pika 2.1 dhe 2.6 të KPPK-së.

Në bazë të nenit 463, par. 1 dhe 2, të KPPK-së, të dëmtuarit janë udhëzuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore-juridike.

Mbi bazën e të dhënave si më lart, në bazë të neneve 248 dhe 365 të KPPK-së, u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti i përgjithshëm-Penal
P.nr.2135/14 të dt:09.06.2017

Zyrtarja Ligjore,
Dafina Ymeri

Gjyqtari,
Kujtim Krasniqi

UDHËZIMI JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.